



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH .nr. 1049/20**  
**1057/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE: N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan, si dhe OE: N.T.G “BLENDI” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: NTSH “ERPO PRINT” SHPK – Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të Shtypur” me numër të prokurimit: 632-20-5688-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-GJAKOVË (KKGJ), më datën: 24.12.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHEN**, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: : N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan, si dhe OE: N.T.G “BLENDI” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të Shtypur” me numër të prokurimit: 632-20-5688-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-GJAKOVË.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të Shtypur” me numër të prokurimit: 632-20-5688-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-GJAKOVË dhe lënda kthehet në Rivlerësim .

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV .**Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan, si dhe OE: N.T.G “BLENDI” - Prishtinë, aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE .T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.12.2020 me nr. 1049/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të Shtypur” me numër të prokurimit: 632-20-5688-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-GJAKOVË (KKGJ), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 60 dhe 61 , të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Neni 3.1 dhe 2 si dhe neni 4.2 i Rregullave për Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Operatori ekonomik ankues OE N.T.G “BLENDI” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.12.2020 me nr. 1057/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material të Shtypur” me numër të prokurimit: 632-20-5688-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-GJAKOVË (KKGJ), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 60, dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
- Neni 3.1 dhe 2 si dhe neni 4.2 i Rregullave për Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtuese i prokurimit në raportin e dt: 18.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan**

***Përgjigje në Pretendimi nr. 1***

Operatori ekonomik ankues N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “EURPO PRINT” SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se në neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, të LPP-së, konkretisht në paragrafin 1 të këtij neni thuhet:

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Gjithashtu në nenin Neni 3 Informatat e përgjithshme te Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në pragrafët 3.1 dhe 3.2 thuhet:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Në nenin Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në paragrafët 4.2 thuhet:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Andaj bazuar në nenet 3 dhe 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe nenit 61 të LPP-së, nuk ka asnjë dëshmi që dëshmon se AK-së ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore, pra nuk ka asnjë dëshmi që ka kërkuar shpjegime nga OE, si dhe nuk ka aplikuar formulën çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

## **LERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE N.T.G "BLENDI" – Prishtinë**

### ***Përgjigje në Pretendimi nr. 1***

Operatori ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se në neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, të LPP-së, konkretisht në paragrafin 1 të këtij neni thuhet:

2. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Gjithashtu në nenin Neni 3 Informatat e përgjithshme të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në paragrafët 3.1 dhe 3.2 thuhet:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- iv. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- v. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- vi. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Në nenin Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në paragrafët 4.2 thuhet:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkojë me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**.

Andaj bazuar në nenet 3 dhe 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe nenit 61 të LPP-së, nuk ka asnjë dëshmi që dëshmon se AK-së ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore, pra nuk ka asnjë dëshmi që ka kërkuar shpjegime nga OE, si dhe nuk ka aplikuar formulën çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

#### ***Përgjigje në Pretendimi nr. 2***

Operatori ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike.

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

|                                        |     |                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Specifikacionet teknike të detyrueshme | 3.1 | Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:<br>a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit; |
|----------------------------------------|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “EURPO PRINT” SHPK, nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, edhe pse mendoj se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 21.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I”, me datë: 22.12.2020 anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues

Operatori Ekonomik N.T.G “BLENDI”, Nuk ka përgjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: **24.12.2020**, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore të OE N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I” – Deçan

Lidhur me pretendimin e Operatori ekonomik ankues N.T. “AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I”, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “EURPO PRINT” SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të

ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se në neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, të LPP-së, konkretisht në paragrafin 1 të këtij neni thuhet:

3. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Gjithashtu në nenin Neni 3 Informatat e përgjithshme të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në pragrafët 3.1 dhe 3.2 thuhet:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- vii. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- viii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- ix. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tilla dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me pragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Në nenin Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në pragrafët 4.2 thuhet:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**.

Andaj bazuar në nenet 3 dhe 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe nenit 61 të LPP-së, nuk ka asnjë dëshmi që dëshmon se AK-së ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore, pra nuk ka asnjë dëshmi që ka kërkuar shpjegime nga OE, si dhe nuk ka aplikuar formulën çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

**Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te OE N.T.G “BLENDI” – Prishtinë**

*Lidhur me pretendimin e* Operatori ekonomik ankues N.T.G “BLENDI”, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH “EURPO PRINT” SHPK, ka ofruar çmim abnormalisht të ulët, dhe se çmimet e ofruar në ofertën e tij janë në kundërshtim me nenin 3, konkretisht me paragrafin 3.1 dhe 3.2, dhe nenit 4 paragrafin 4.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, të LPP-së, konkretisht në paragrafin 1 të këtij neni thuhet:

4. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Gjithashtu në nenin Neni 3 Informatat e përgjithshme te Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në paragrafët 3.1 dhe 3.2 thuhet:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- x. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- xi. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- xii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Në nenin Neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht në pragrafët 4.2 thuhet:

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**.

Andaj bazuar në nenet 3 dhe 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe nenit 61 të LPP-së, nuk ka asnjë dëshmi që dëshmon se AK-së ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore, pra nuk ka asnjë dëshmi që ka kërkuar shpjegime nga OE, si dhe nuk ka aplikuar formulën çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

**Lidhur me pretendimin** e Operatorit ekonomik ankues N.T.G "BLENDI", se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, nuk e ka ofruar Deklaratën për specifikime teknike. Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit në nenin 3.1 është kërkuar:

|                                        |     |                                                                                                                                                                                                                                                              |
|----------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Specifikacionet teknike të detyrueshme | 3.1 | Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:<br>a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit; |
|----------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NTSH "EURPO PRINT" SHPK, nga ana e ekspertit shqyrtues është vetëtuar se nuk është Deklarata për Specifikacionet teknike, mirëpo paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kjo është mbetur në shumë dosje si shabllon dhe është me rëndësi që OE-te të plotësojnë specifikacionet teknike ashtu siç AK ka kërkuar, nëse ka kërkuar, kjo mund të konsiderohet një devijim i vogël sepse mungesa e dokumentit të lartcekur nuk ndryshon asgjë në kushtin material të tenderit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së, specifikisht nenit 61 të LPP-se si dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK – "KK Gjakovë"
- 1x1 OE N.T. "AGIMI-DE Hajrije Selmanaj B.I" & N.T.G "BLENDI"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.